



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 699, datë 30.11.2023

“PËR DHËNIE LEJE TË PAPAGUAR GJYQTARIT {...}”

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen plenare të datës 30.11, si u njoh me materialet e çështjes, relacionin “*Mbi kërkesën e gjyqtarit {...} për dhënie leje të papaguar*”, për gatitur nga relatorja, znj. Irena Plaku, si dhe pasi shqyrtoi propozimin e Komisionit për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VËREN:

I. FAKTET E ÇËSHTJES

1. Më datë 03.11.2023 Z. {...}, gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë, ka paraqitur “*Kërkesë për leje të papaguar për arsye familjare për një periudhë më pak se dy mujore nga data 07.12.2023 - 26.01.2024*”, protokolluar pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me nr. 5745 prot, datë 03.11.2023.

2. Në kërkesën me shkrim z. {...} parashtron rrethanat familjare mbi të cilat bazohet kërkesa për leje të papaguar, duke evidentuar faktin se bashkëshortia e tij, znj. Ejona Lazellari¹, është shtatëzënë dhe në pritje të lindjes së fëmijës së tyre, dhe ajo së bashku me dy fëmijët e tjerë kanë udhëtuar për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku edhe ai do të udhëtojë, për të qëndruar pranë tyre. Ai parashtron se do të udhëtojë për në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe do të qëndrojë atje nga data 07.12.2023 deri në datën 26.01.2024.

3. Sa i përket arsyeve konkrete për të cilat kërkohet dhënia e lejes së papaguar, z. {...}, ndër të tjera, parashtron se : “*...Ju drejtohem me anë të kësaj kërkesë për miratimin e lejes së papaguar*

¹ Znj. Ejona Lazellari është gjyqtare pranë Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Fier, por është transferuar përkohësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë me Vendim nr. 93, datë 06.03.2023. Referuar informacionit të përcjellë nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ku ka ushtruar funksionin Znj. Ejona Lazellari, rezulton se nga data 02.11.2023 Znj. Lazellari ka filluar lejen e paralindjes.

për arsye familjare, në kushtet kur bashkëshortja ime Znj. Ejona Lazellari është shtatëzënë dhe në pritje të lindjes së fëmijës dhe për këtë arsye, ajo së bashku me fëmijët do të udhëtojnë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ku do u bashkohem edhe unë për periudhën kohore të qëndrimit nga data 07.12.2023 deri në datën 26.01.2024.”.

4. Bashkëlidhur kërkesës me shkrim, z.Fuçia ka paraqitur dokumentacionin mbështetës si më poshtë:

(i) *Rezervimi për biletën e udhëtimit vajtje- ardhje në datat 07.12.2013- 26.01.2024;*

II. PROCEDURA E ZHVILLUAR

5. Komisioni për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me qëllim trajtimin e kërkesës së gjyqtarit {...}, duke iu referuar parashikimeve të nenit 24, të ligjit nr. 96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 72, datë 20.02.2019 “*Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor*”, i kërkoi i Zv/Kryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, informacion në lidhje me ngarkesën e gjyqtarëve të kësaj gjykate si dhe mendimin e tij lidhur me cenimin ose jo të funksionalitetit të gjykatës. Gjithashtu, i kërkoi kancelares së gjykatës, informacion në lidhje me ngarkesën e gjyqtarëve dhe të gjyqtarit {...}.

6. Zv/Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë, nëpërmjet postës elektronike, datë 07.11.2023, ka përcjellë mendim, duke parashikuar ndër të tjera se; “*Leja e papaguar e kërkuar nga Gj. {...} për periudhën 07.12.2023 deri në datë 26.01.2024 për arsye familjare nuk çënon funksionalitetin e Gjykatës, pasi nga data 15- dhjetor 2023 deri në 15 janar 2024 është parashikuar procesi i bartjes vjetore së dosjeve. Gjyqtarët gjatë kësaj periudhe nga data 15- dhjetor 2023 deri në 15 janar 2024 rekomandohen që të mos zhvillojnë procese gjyqësore me përjashtim të rasteve të cilat vlerësohen të ngutshme nga gjyqtarët, për shkak të mbarimit të afateve të paraburgimit”.*

7. Sa i përket ngarkesës aktuale të gjyqtarit {...} dhe gjyqtarëve të tjerë, sipas të dhënave të dërguara nga kancelarja e gjykatës,, nëpërmjet postës elektronike më datë 07.11.2023, që kanë të bëjnë me raportimin për tre mujorin Korrik- Shtator 2023, rezulton se :

1. Gjyqtari {...} aktualisht ka në shqyrtim 108 çështje.
2. Ngarkesa mesatare aktuale e gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë është rreth 221 çështje për gjyqtar. Pra në këtë raportim nuk janë përfshirë 4 gjyqtarët e tjerë të caktuar nga Këshilli në muajin Tetor 2023.

8. Sa i përket organikës së gjykatës, ka rezultuar se Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, e ka organikën me 16 gjyqtarë, por aktualisht ushtrojnë funksionet pranë kësaj gjykate

vetëm 15 gjyqtarë, kjo për shkak se : 1 gjyqtare është shkarkuar nga detyra me vendim të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

9. Nga ana e Komisionit për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, veç kërkesës së gjyqtarit dhe provave bashkëngjitur saj, u administruan të dhënat e dosjes personale të gjyqtarit.

10. Komisioni për Vlerësimin e Etikës dhe Veprimtarinë Profesionale, zhvilloi procedurën administrative në përputhje me pikën VI të Vendimit Nr. 72 dt. 20.05.2019 “*Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor*”, brenda 7 ditëve nga depozitimi i kërkesës së gjyqtarit dhe në mbledhjen e datës 16.11.2022 vendosi që kjo çështje t’i kalojë për shqyrtim Mbledhjes Plenare.

11. Kjo kërkesë u mor në shqyrtim në Mbledhjen Plenare të Këshillit më datë 30.11.2023, brenda afatit 15 ditor nga paraqitja e propozimit në referim të parashikimeve të pikës 6 shkronja “b” të Vendimit nr.72 datë 20.05.2019 të KLGJ.

III. KUADRI LIGJOR I ZBATUESHËM

12. Në nenin 24, paragrafi 3 i ligjit 96/2016 “*Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve*”, përcaktohet se: “3. *Magjistrati mund të kërkojë leje të papaguar deri në 2 vjet për qëllime kualifikimi profesional dhe specializime në një institucion trajnimi, ose për arsye familjare ose shëndetësore. Leja e papaguar mund të merret e gjitha njëherësh ose në periudha të ndryshme sipas kërkesës së magjistratit*”.

13. Në vendimin nr. 72 datë 20.05.2019 për “*Lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor*”, përcaktohen kriteret dhe procedurat e dhënies së këtyre lejeve. Lidhur me kriteret dhe procedurat e dhënies së lejes për arsye familjare dhe/ose shëndetësore, pika 8 e vendimit të sipërcituar parashikon si vijon:

... 8. *Leja për arsye familjare dhe/ose shëndetësore për një periudhë nga 30 ditë deri në 2 vjet, jepet nga Këshilli, si më poshtë:*

- a. *Gjyqtari që kërkon këtë leje, paraqet kërkesën me shkrim në Këshill, të paktën 30 ditë para kohës kur kërkon të fillojë kjo leje. Në rast të nevojave urgjente kërkesa paraqitet menjëherë pa vonesë. Kërkesa duhet të përmbajë përshkrimin e arsyes dhe afatin e lejes së kërkuar. Kërkesës duhet t’i bashkëngjitet dokumentacioni justifikues si dhe mendimi me shkrim nga kryetari i gjykatës në lidhje me cenimin ose jo të funksionalitetit të gjykatës;*
- b. *Kërkesa e gjyqtarit trajtohet nga Komisioni përkatës, i cili brenda 7 ditëve i përcjell Mbledhjes Plenare propozimin për miratimin ose refuzimin e lejes. Këshilli merr vendim për këtë kërkesë brenda 15 ditëve nga paraqitja e propozimit;*

- c. Kjo leje mund të jepet e gjitha njëherësh, ose në periudha të ndryshme, sipas kërkesës së gjyqtarit, por në total jo më shumë se 2 vjet. Në vendimin për dhënien e lejes, Këshilli shprehet edhe në lidhje me rihedhjen ose jo në short të çështjeve që gjyqtari ka në shqyrtim;
- d. *Këshilli mund të refuzojë kërkesën për këtë leje, sipas parimit të proporcionalitetit, duke respektuar të drejtën për jetë private dhe familjare, si dhe pa vënë në rrezik përmbushjen e funksionit me efikasitet dhe në kohë.*

IV. ANALIZA LIGJORE E ÇËSHTJES

14. Ligji për Statusin, si pjesë e garancive të parashikuara nga neni 138 i Kushtetutës që kanë për qëllim të sigurojnë pavarësinë e sistemit gjyqësor, përveç pushimeve vjetore, ka parashikuar edhe të drejtën e magjistratit për të përfituar pushime të tjera. Në këtë kontekst neni 24 i këtij Ligji ka si qëllim që, nëpërmjet përcaktimit të llojeve të pushimeve të tjera dhe rregullave për marrjen e tyre, të krijojë kushtet e përshtatshme për të pasur një sistem gjyqësor efektiv dhe funksional, i cili nuk është privilegj apo qëllim në vetvete, por i shërben garantimit të një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër dispozita ka pasur si qëllim të mbrojë edhe të drejtën e marrjes së pushimeve të tjera nga magjistratët, veç lejen e tyre vjetore, duke e parashikuar një të drejtë të tillë drejtpërdrejt në ligj, çka e bën atë element të garancive funksionale për magjistratët.

15. Sa i përket llojit të lejeve të papaguara që jepen nga Këshilli, neni 24 i Ligjit nr.96/2016 dhe Vendimi nr.72 datë 20.05.2019 i Këshillit të Lartë Gjyqësor, në pikën 4, parashikojnë tre lloje të lejes dhe konkretisht :

- a. Leje prindërore;
- b. Leje për qëllime kualifikimi dhe specializimi në një institucion trajnimi, jashtë periudhës së trajtimit vazhdues;
- c. **Leje për arsye familjare** dhe/ose shëndetësore;

16. Në kërkesën e tij, Z.Fuçia parashtrohet se kërkohet leje e papaguar për arsye familjare, sipas përcaktimeve të nenit 24, paragrafi i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve”.

17. Sa i përket kushteve për dhënien e lejes për arsye familjare, sipas parashikimeve të pikës 8 të vendimit nr. 72, datë 20.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në rastin konkret, rezulton se:

- a. leja e kërkuar është për një periudhë më pak se 2 vjet, e konkretisht për rreth 1 muaj muaj e 19 ditë, nga data 07.12.2023 – 26.01.2024;
- b. gjyqtari ka paraqitur kërkesën me shkrim më datë 03.11.2023, ndërkohë që leja kërkohet të fillohet në datë 07.12.2023, pra *kërkesa është paraqitur më shumë se 30 ditë para kohës* së fillimit të afatit për të cilin kërkohet dhënia e lejes;
- c. në kërkesën e gjyqtarit përcaktohet qartë arsyeja e lejes, e konkretisht për arsye familjare sipas përcaktimeve të nenit 24/ 3 të ligjit 96/2016. Gjithashtu, është

përcaktuar qartë kohëzgjatja e lejes, duke kërkuar leje për një periudhë më pak se dy muaj, duke filluar nga data 07.12.2023-26.01.2024.

- d. kërkesa e gjyqtarit {...} është shoqëruar me dokumentacion justifikues. Gjithashtu është paraqitur mendimi me shkrim i zëvendëskryetarit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë në të cilin, ndër të tjera, theksohet se: *“Leja e papaguar e kërkuar nga Gj. {...} për periudhen 07.12.2023 deri në datë 26.01.2024 për arsye familjare nuk çënon funksionalitetin e Gjykatës, pasi nga data 15- dhjetor 2023 deri në 15 janar 2024 është parashikuar procesi i bartjes vjetore së dosjeve. Gjyqtarët gjatë kësaj periudhe nga data 15- dhjetor 2023 deri në 15 janar 2024 rekomandohen që të mos zhvillojnë procese gjyqësore me përjashtim të rasteve të cilat vlerësohen të ngutshme nga gjyqtarët, për shkak të mbarimit të afateve të paraburgimit”*. Lidhur me cenimin e funksionalitetit të gjykatës, veç mendimit të zëvendëskryetarit parashtruar më sipër, është administruar informacion lidhur me ngarkesën aktuale të gjyqtarit nga i cili rezulton se ajo ka në shqyrtim 108 çështje.

18. Për sa më sipër, vlerësohet se;

- kërkesa e gjyqtarit {...} për dhënie leje të papaguar për arsye familjare, për një periudhë më pak se dy muaj, nga data 07.12.2023- 26.01.2024, përmbush kriteret e përcaktuara në neni 24, të ligjit nr. 96/2016 dhe vendimin nr.72, datë 20.05.2019 për *“Lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”*.
- arsyeja për këtë leje, e paraqitur nga gjyqtari, është e pranueshme, pasi lidhet drejtpërdrejtë me të drejtën e tij për jetë familjare. Kjo e drejtë i garantohet atij, si çdo shtetasi, nga neni 8 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
- mungesa e gjyqtarit në ushtrimin e funksionit të tij pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë, për shkak të ngarkesës që ka ai si gjyqtar dhe e gjithë gjykata në tërësi, **nuk vë në rrezik përmbushjen e funksionit me efikasitet dhe në kohë.**

19. Sa i përket çështjeve gjyqësore të cilat gjyqtari {...} ka në shqyrtim në kreun VII, pika 8, shkronja ç) të vendimit nr. 72, datë 20.05.2019, parashikohet se :*“Në vendimin për dhënie lejes, Këshilli shprehet edhe në lidhje me rihedhjen ose jo në short të çështjeve që gjyqtari ka në shqyrtim”*. Në këtë kuadër vlerësohet se çështjet që gjyqtari ka në shqyrtim **ditën e fillimit të lejes së papaguar**, duhet t’i mbeten atij për shkak të periudhës së shkurtër për të cilën kërkohet leja. Edhe Zv/kryetari i gjykatës shprehet kështu në mendimin e tij *“Nëse dosjet që Gj. {...} ka në gjykim do të rishortoheshin kjo do të sillte mbingarkesë për gjyqtarët e tjerë, pasi gjykata ka aktualisht 3 gjyqtarë më pak (për shkak të shkarkimit nga KPK) dhe rekomandoj që duke marrë në konsideratë kohën relativisht të shkurtër prej afërsisht 15 ditë pune (duke zbitur ditët e mbartjes vjetore të dosjeve) që do mungojë Gjyqtari, dosjet që ka në gjykim të mbahen prej tij dhe të mos rishortohen”*, ndërsa kancelarja, në lidhje me ngarkesën e gjyqtarëve shprehet *“Referuar ngarkesës së gjyqtarëve të tjerë, rezulton të kenë dy (2) ose tre (3) herë më shumë ngarkesë në krahasim me gjyqtarin {...}”*.

Referuar të dhënave statistikore të përcjellë nga Kancelarja e gjykatës, rezulton se ato përfshijnë ngarkesën e gjyqtarëve për tremujorin Korrik – Shtator 2023, të cilat i janë raportuar KLGJ. Në këto të dhëna nuk përfshihen 4 gjyqtarët e rinj, të caktuar në detyrë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë në datë 21.10.2023.

Lidhur me parashikimet e nenit 25, pika 3, shkronja d) të Ligjit 98/2016, ku rindarja e çështjeve me short lejohet kur është e nevojshme për shkaqe të justifikuara, bazuar sa më lart, duke qenë se koha e lejes së papaguar është shumë e shkurtrë dhe ngarkesa e gjyqtarëve më të vjetër në detyrë është shumë e lartë, rekomandohet që dosjet e Z. {...} të mos rishortohen, por t'i mbeten atij.

Sa i përket përjashtimit të gjyqtarit {...} nga procedurat e shortimit të dosjeve që regjistrohen në gjykatë, gjatë periudhës së lejes së papaguar, në kreun V, pika 2, të vendimit nr. 554, datë 29.12.2022 *“Për ndarjen me short të çështjeve gjyqësore”* të Këshillit të Lartë Gjyqësor parashikohet se: *“Kryetari i Gjykatës, pas kërkesës së motivuar të gjyqtarit, mund të përjashtojë nga shorti pjesërisht apo tërësisht gjyqtarin, gjatë lejes së papaguar, me afat deri në 30 ditë. Në këto raste Kryetari i Gjykatës disponon me vendim të arsyetuar”*. Pra sipas kësaj dispozite, është kryetari i gjykatës ai që vendos përjashtimin e gjyqtarit nga shortimi i çështjeve që regjistrohen në gjykatë bazuar në kërkesën e motivuar të gjyqtarit, por deri në një periudhë deri në një muaj. Në këto kushte, parasysh faktin se koha e lejes së papaguar është më e gjatë se një muaj, si dhe duke marrë parasysh ngarkesën e gjyqtarëve të tjerë, ku gjyqtarët e caktuar së fundi normalisht kanë një ngarkesë më të ulët, vlerësohet se gjatë periudhës së lejes së paguar gjyqtari duhet të përjashtohet tërësisht nga procedura e shortimit i çështjeve gjyqësore. Përjashtimi i tij nga procedura e shortit nuk çënon parimin e barazisë së shpërndarjes së çështjeve si dhe efikasitetin e drejtësisë në aspektin e respektimit të afatit të arsyeshëm të gjykimit.

V. KONKLUZIONI

20. Për sa arsyetohet më lart, Këshilli vlerëson se kërkesa e gjyqtarit {...} për dhënien e lejes së papaguar për arsye familjare, për një periudhë nga data 07.12.2023 deri në datën 26.01.2024, përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 96/2016, si dhe vendimit nr.72, datë 20.05.2019 për *“Lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”* dhe si e tillë duhet të pranohet.

21. Në lidhje me të drejtën e ankimit, në referim të parashikimeve të nenit 100 të Ligjit nr.115/2016, i ndryshuar me ligjin nr. 47/2016, kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

PËR KËTO ARSYE;

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 61, 68 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, nenin 24, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe vendimin nr. 72, datë 20.05.2019 “Për lejet e papaguara të gjyqtarëve që jepen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor”,

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës të Z. {...}, gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë, për dhënie leje të papaguar, për arsye familjare, për periudhën nga data 07.12.2023 – 26.01.2024.
2. Përfshirjen tërësisht nga shorti i gjyqtarit {...}, gjatë periudhës së lejes së papaguar, nga data 07.12.2023 - 26.01.2024.
3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit {...} dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR